

Hagë, 16 dhjetor 2022

Përmbledhje e Aktgjykimit në çështjen gjyqësore

*Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës (KSC-BC-2020-05)*

TRUPI GJYKUES I do të shqiptojë sot Aktgjykimin në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*. Trupin Gjykses e përbëjnë gjykatësit Roland Dekers, Zhilber Biti, dhe Vladimir Mikula si gjykatës rezervë, dhe unë, Mapi Feld-Folia, si kryegjykatëse. Ky aktgjykim shqiptohet publikisht, në emër të popullit të Kosovës dhe në praninë e z. Mustafa.

1. Ndonëse do të lexoj përmbledhjen e konstatimeve kryesore të Trupit Gjykses, kjo përmbledhje nuk është pjesë e Aktgjykimit, i cili është i vetmi version autoritativ i vendimit dhe konstatimeve të Trupit Gjykses. Përmbledhja, që nuk është version autoritativ, do të jetë e disponueshme në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.
2. Ky proces gjyqësor ka të bëjë me veprimet e z. Mustafa në një kompleks në Zllash në Kosovë, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999.
3. Aktgjykimi i sotshëm shënon një moment të rëndësishëm për Dhomat e Specializuara. Ky është aktgjykimi i parë për krime lufte i kësaj Gjykate dhe është një hap më tej për vendosjen e drejtësisë dhe vënien para përgjegjësisë për shkelje të rënda të së drejtës humanitare dhe penale ndërkombëtare, që pretendohet se u kryen në Kosovë midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000.
4. Para se të kalojë te konstatimet e veta në lidhje me akuzat e ngritura kundër z. Mustafa, Trupi Gjykses dëshiron të trajtojë disa aspekte të rëndësishme.
5. Së pari, duket se ndonjëherë ka konceptim të gabuar se këto akuza u ngritën kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo gjithë popullit të Kosovës. Nuk ka asgjë

më larg së vërtetës se kjo. Përkundrazi, pikërisht populli i Kosovës përmes Kuvendit, zgjodhi të krijonte dhe t'i jepte kompetenca këtij institucioni.

6. Gjithashtu, përgjegjësia penale para Dhomave të Specializuara është vetëm individuale. Ky parim mishërohet në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara. Ajo u jep juridiksion Dhomave të Specializuara vetëm mbi persona fizikë. Në përputhje me këtë, Dhomat e Specializuara përballin me përgjegjësi penale persona, vetëm për krime që ata i kanë kryer individualisht. Në këtë çështje gjyqësore, akuzat e paraqitura nga Prokurori i Specializuar kanë të bëjnë vetëm me përgjegjësinë penale individuale të z. Mustafa dhe pjesëmarrjen e tij në krimet e luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme, të paraqitura në aktakuzën e Prokurorit të Specializuar. Në asnjë moment nuk u gjykua UÇK-ja. Z. Mustafa dhe veprimet e pretenduara të tij ishin ato që u gjykuan.

7. Së dyti, viktimat që pretendohet se pësuan dëm si pasojë e veprimeve të z. Mustafa, janë qytetarë të Kosovës dhe të përkatësisë etnike shqiptare. Përpyekjet e tyre për të kërkuar drejtësinë dhe të vërtetën janë thelbi i këtij procesi.

8. Së fundi, Trupi Gjyqësor ka dëgjuar disa dëshmi të dorës së parë nga dëshmitarë. Disa nga ata janë gjithashtu edhe viktima pjesëmarrëse në këtë proces gjyqësor. Këta dëshmitarë dëshmuar për ngjarjet traumatike që ata përjetuan dhe ndikimin e vazhdueshëm psikologjik të këtyre ngjarjeve në jetën e tyre dhe të familjeve të tyre.

9. Trupi Gjyqësor është i vetëdijshëm se duhet guxim i jashtëzakonshëm për të dhënë dëshmi. Viktimat këtë e bënë në një atmosferë të përhapur të frikës dhe frikësimit që vazhdon në Kosovë edhe sot e kësaj dite. Gjatë të gjithë gjykimit, Trupi Gjyqësor dëgjo dëshmi nga një numër dëshmitarësh të cilët bënë të ditur se ata që bashkëpunojnë – ose që besohet se bashkëpunojnë – me Dhomat e Specializuara ose Zyrën e Prokurorit të Specializuar, etiketohen në Kosovë si “tradhtarë” apo “bashkëpunëtorë” dhe janë objekt i kërcënimeve dhe frikësimit, qoftë ata vetë, ose fëmijët e tyre. Viktimat që u paraqitën si dëshmitarë në këtë çështje gjyqësore tani jetojnë në frikë të vazhdueshme se diçka do t'u ndodhë atyre ose familjeve të tyre. Ata

edhe sot e kësaj dite ende nuk janë në gjendje të flasin lirshëm për ngjarjet traumatike që përjetuan dhe dëmin që pësuan.

10. Atmosfera e frikës dhe frikësimit – e drejtuar kundër dëshmitarëve që japin dëshmi në hetimet ose ndjekjet penale të krimeve që pretendohet të jenë kryer nga ish-pjesëtarë të UÇK-së – është një prej arsyeve për krijimin e kësaj gjykate dhe vendosjen e saj këtu në Hagë, e jo në Kosovë. Kjo është gjithashtu arsyeja pse Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Trupi Gjykoës caktoan masa mbrojtëse për dëshmitarë dhe viktima pjesëmarrëse, për të mbajtur të fshehtë identitetin e tyre nga publiku. Identitetet e viktimave iu bënë të ditura z. Mustafa dhe avokatëve të tij për të garantuar të drejtën e tij për gjykim të drejtë.

11. Si rrjedhojë e masave mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat pjesëmarrëse, disa seanca gjyqësore ishin private – d.m.th., publiku nuk mund të dëgjonte çfarë diskutohej në sallën e gjyqit. Kjo garantoi mbrojtjen e efektshme të identiteteve të atyre që donin të dëshmonin për përjetimet e tyre para Trupit Gjykoës. Për të njëjtën arsye, Trupi Gjykoës urdhëroi edhe veçimin e përkohshëm të z. Mustafa dhe disa kufizime të komunikimeve të tij me jashtë. Trupi Gjykoës megjithatë u ka kushtuar gjithmonë vëmendje të drejtave e z. Mustafa dhe çdo herë ka balancuar interesat e dëshmitarëve dhe viktimave nga njëra anë, dhe të drejtave të z. Mustafa nga ana tjetër.

12. Tani unë do të filloj me një përmbledhje të aktgjykimit.

### **Në lidhje me të akuzuarin dhe akuzat**

13. Z. Salih Mustafa – i akuzuari në këtë çështje gjyqësore – është shtetas i Kosovës, i lindur më 1 janar 1972, në Prishtinë, në Kosovë.

14. Sipas akuzave të paraqitura nga Prokurori i Specializuar dhe të konfirmuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, gjatë gjithë kohës që ka lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar, z. Mustafa ishte komandant i njësitit gueril BIA, një njësit i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sipas Aktakuzës së Konfirmuar, BIA e kishte bazën në një kompleks në Zllash, në rajonin e Gollakut, në Kosovë. Pretendohet se ky kompleks

përdorej nga BIA si vendstrehim i sigurt dhe si qendër ndalimi dhe marrje në pyetje. Prokurori i Specializuar pretendon se krimet e paraqitura në aktakuzë u kryen në këtë kompleks. Unë do t'i referohem me "kompleksi i ndalimit në Zllash".

15. Prokurori i Specializuar ngriti kundër z. Mustafa katër akuza për krime lufte në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit: ndalim arbitrar (Pika 1), trajtim mizor (Pika 2), torturë (Pika 3) dhe vrasje e paligjshme (Pika 4). Prokuroria pretendoi se z. Mustafa është personalisht përgjegjës - sipas formave të ndryshme të përgjegjësisë penale – në bazë të nenit 16(1)(a) dhe (c) të Ligjit, për ndalimin arbitrar, trajtimin mizor dhe torturimin e së paku gjashtë personave në kompleksin e ndalimit në Zllash, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, dhe për vrasjen e paligjshme të një personi, afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999.

16. Z. Mustafa u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.

### **Do të bëj një përmbledhje të shkurtër të gjykimit**

17. Gjykimi filloi më 15 shtator 2021 me deklaratat hyrëse të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtëses së Viktimave. Mbrojtja bëri deklaratën hyrëse më 22 mars 2022.

18. Gjatë gjykimit, Trupi Gjykues dëgjoji 28 dëshmitarë - 13 të thirrur nga Prokurori i Specializuar dhe 15 të thirrur nga Mbrojtja. Trupi Gjykues gjithashtu shqyrtoi deklaratat me shkrim, prova shkresore dhe aktekspertiza.

19. Për më tepër, tetë viktimat morën pjesë në proces dhe të gjithë ishin nën masa mbrojtëse.

20. Pas seancës së deklaratave përmblyëse, Kryegjykatësja mbylli gjykimin e çështjes më 15 shtator 2022, dhe Trupi Gjykues filloi kuvendimet e periudhës prej 90 ditësh, në përputhje me rregullën 159 (1) të Rregullores.

## Vlerësimi i provave

21. Tani do të përshkruaj se si Trupi Gjykes i vlerësoi provat e paraqitura në këtë çështje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtja.

22. Para se të nxirrte konstatimet e veta faktike dhe ligjore, Trupi Gjykes kreu një vlerësim të përgjithshëm të besueshmërisë dhe mbështetshmërisë në dëshmitarët e Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtjes. Trupi Gjykes gjithashtu mori parasysh ndikimin e atmosferës mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve mbi dëshmitë e këtyre dëshmitarëve.

23. Në lidhje me dëshmitarët e Prokurorit të Specializuar, Trupi Gjykes konstatoi se dëshmitë e tyre në masë të madhe ishin të qarta, koherente dhe përputhëse. Përshkrimet që bënë ishin të gjalla, të hollësishme dhe të rrëfyera me emocion. Kjo tregon se viktimat i përjetuan ngjarjet personalisht. Gjithashtu, dëshmitë e dëshmitarëve konfirmuan njëra-tjetrën dhe u konfirmuan edhe nga prova të tjera të besueshme dhe të mbështetshme që u paraqitën Trupit Gjykes. Në tërësi, Trupi Gjykes konstatoi se dëshmitë e dëshmitarëve të thirrur nga Prokurori i Specializuar ishin të besueshme dhe u mbështet në to, edhe pse në masë të ndryshme.

24. Në lidhje me dëshmitarët e Mbrojtjes, Trupi Gjykes veçoi disa faktorë që ndikuan negativisht në besueshmërinë e tyre. Ndër këta faktorë përfshiheshin:

- lidhjet e forta dhe të ngushta të dëshmitarëve me z. Mustafa, që buronin nga raporti vartës-epror gjatë kohës kur ishin në njësitin BIA në 1999 dhe marrëdhëniet personale midis tyre (janë miq ose kanë lidhje familjare);
- komunikimet e afërta të dëshmitarëve me z. Mustafa para dhe pas intervistave të tyre me Prokurorin e Specializuar;
- shprehjet e fuqishme të mosbesimit ose anshmërisë në rrjetet sociale kundër proceseve gjyqësore para Dhomave të Specializuara; dhe
- ngurrimi i disa dëshmitarëve për të dhënë informacion për njësitin BIA dhe për të pranuar se kishin lidhje me ndonjë veprimtari të BIA-s.

25. Gjithashtu, Trupi Gjykues mori parasysh gatishmërinë e disa dëshmitarëve të caktuar të Mbrojtjes për t'i përshtatur dëshmitë e tyre me ato të dëshmitarëve të tjerë në favor të z. Mustafa. Dëshmitë e këtyre dëshmitarëve rrjedhimisht u shqyrtuan me kujdesin më të madh. Gjithashtu, disa dëshmitarë të Mbrojtjes nuk kishin njohuri të duhura që Trupi Gjykues të mund të mbështetej në ta. Në disa raste të tjera, dëshmitë e tyre në thelb nuk lidheshin me akuzat dhe rrjedhimisht Trupi Gjykues nuk u mbështet në to.

26. Së fundi, Trupi Gjykues konstatoi se shumë dëshmitarë e kishin të vështirë të mbanin mend datat e sakta ose kishin probleme me kujtesën. Disa nga këta dëshmitarë u thirrën nga Mbrojtja për të dëshmuar lidhur me një alibi të mundshme. Trupi Gjykues mori parasysh vështirësitë sistematike në mbajtjen mend të datave si faktor me gjasë ndikues në mbështetshmërinë në dëshmitë e dëshmitarëve kur vlerësoi alibinë e paraqitur nga Mbrojtja.

### **Roli i të akuzuarit**

27. Tani do të paraqes një përmbledhje të shkurtër të konstatimeve të Trupit Gjykues në lidhje me rolin e z. Mustafa në UÇK në kohën që mbulon Aktakuza e Konfirmuar.

28. Trupi Gjykues konstatoi se në maj 1998, z. Mustafa u emërua komandant i njësitit të porsaformuar BIA. Njësi BIA ishte pjesë e UÇK-së. Z. Mustafa e mbajti këtë post afërsisht deri nga mesi i qershorit 1999, kur njësi BIA u shpërnda. Z. Mustafa njihej me nofkën "Cali" dhe atë gjithashtu e thërrisnin "Komandant Cali". Sikurse deklaroi edhe vetë z. Mustafa dhe konfirmuar nga prova të shumta, ai ishte komandanti i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s gjatë gjithë kohës së ekzistencës së BIA-s, duke përfshirë edhe në prill të vitit 1999, dhe gjithashtu ishte përgjegjës për grumbullimin e të dhënave të zbulimit. I akuzuari kishte kompetencë për emërimë në njësitin BIA-s, për t'u dhënë urdhra vartësve të vet dhe për t'i disiplinuar.

### **Alibia**

29. Para se të kaloj në konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me krimet e paraqitura në aktakuzë, do të bëj një përmbledhje të konstatimeve që kanë të bëjnë me alibinë. Mbrojtja parashtroi se z. Mustafa nuk mund t'i kishte kryer krimet e paraqitura në aktakuzë. Ajo pretendoi se gjatë periudhës që përkon me këto akuza, z. Mustafa ishte në vende të tjera, e jo në kompleksin e ndalimit në Zllash. Trupi Gjykses analizoi me kujdes provat në tërësi dhe konstatoi se këto prova nuk vërtetonin dyshim të arsyeshëm në lidhje me praninë e z. Mustafa në vendin e krimit. Konkretisht, Trupi Gjykses konstatoi se provat lidhur me alibinë janë përgjithësisht të mjegullta ose mospërputhëse, sidomos kur krahasohen me provat përputhëse dhe të shumta që tregojnë se z. Mustafa ishte i pranishëm në vendin e krimit në periudhat përkatëse. Për më tepër, prova të besueshme dhe konfirmuese, ndër të tjera edhe nga vetë z. Mustafa, treguan se ai ishte në gjendje të lëvizte nëpër territorin përreth Zllashit dhe se në fakt e bëri këtë rregullisht gjatë prillit të 1999-ës.

### **Krimet e paraqitura në aktakuzë**

30. Tani po u kthehem konstatimeve të Trupit Gjykses lidhur me krimet e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.

### **Do të filloj me Pikën 1 në lidhje me ndalimin arbitrar**

31. Nga tërësia e provave, Trupi Gjykses konstatoi se të paktën gjashtë personave iu hoq liria afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999 në kompleksin e ndalimit në Zllash. Viktimat u arrestuan nga anëtarë të BIA-s ose ushtarë të tjerë të UÇK-së në vende të ndryshme përreth Zllashit. Më tej ata iu dorëzuan anëtarëve të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash. Provat vërtetojnë qartësisht se kompleksi i ndalimit në Zllash kontrollohej vetëm nga BIA dhe komandanti i saj, z. Mustafa.

32. Trupi Gjykses konstatoi se, në asnjë çast gjatë mbajtjes në ndalim, viktimave nuk iu dhanë garanci procedurale bazë, të detyrueshme për zbatim sipas së drejtës humanitare ndërkombëtare, për persona të cilëve u hiqet liria. Konkretisht, ata nuk u

informuan për arsyet e heqjes së lirisë; nuk u nxorën para një gjykatësi apo një autoriteti tjetër kompetent; dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonin ligjshmërinë e mbajtjes në ndalim.

33. Gjithashtu, provat vërtetuan se z. Mustafa ishte i pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash disa herë gjatë prillit 1999. Këtu përfshihej momenti kur një nga viktimat iu dorëzua anëtarëve të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash, në fillim të prillit 1999, si dhe herë të tjera gjatë dy javëve të para të prillit 1999. Trupi Gjykues gjithashtu konstatoi se z. Mustafa i urdhëroi vartësit e tij të BIA-s, t'i kthenin të ndaluarit në vendin ku mbaheshin, pasi ishin marrë në pyetje. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstatoi se z. Mustafa qëllimisht u hoqi lirinë viktimave dhe e dinte se atyre nuk iu dha asnjë garanci bazë gjatë gjithë periudhës së ndalimit të tyre.

34. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstatoi se Prokurori i Specializuar ka vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm se u krye krimi i luftës i ndalimit arbitrar i Pikës 1 kundër të paktën gjashtë personave në kompleksin e ndalimit në Zllash, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999.

### **Tani do të kaloj në Pikat 2 dhe 3 që janë trajtimi mizor dhe tortura**

35. Trupi Gjykues konstatoi se të ndaluarit e kompleksit të ndalimit në Zllash u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese të ndalimit. Ata u mbajtën në ahure të bagëtive, në kushte të mjerueshme, në mes të bajgave të bagëtive. Ata nuk kishin shtretër dhe ishin të detyruar të flinin në tokë, në pellgje uji, mbi kashtë, ose – në rastin më të mirë – në grazhdin e ushqimit të kafshëve. Në ahur ishte gjithnjë terr. Të ndaluarit nuk kishin ushqim të mjaftueshëm. Dëshmitarët dëshmuan se kalonin dy a tri ditë pa ngrënë. “Harrojsha kur po hamë”, tha njëri nga dëshmitarët. Të ndaluarit gjithashtu nuk kishin ujë të mjaftueshëm e kur kërkuan ujë, ushtarët e BIA-s urinuan mbi ta duke u thënë: “Qe uji”. Ata lejoheshin të shkonin në nevojtoresh shumë rrallë dhe detyroheshin t'i kryenin nevojat personale në ahur, në një kovë, në prani të njëri-tjetrit.



Trupi Gjykues gjithashtu konstatoi se të ndaluarve iu refuzua ndihma mjekësore, dhe nuk lejoheshin të flisnin me njëri-tjetrin, duke u kërcënuar me vdekje.

36. Gjithashtu, provat tregojnë se z. Mustafa dhe vartësit e tij të BIA-s, në kompleksin e ndalimit në Zllash rregullisht i keqtrajtuat të ndaluarit fizikisht dhe psikologjikisht. Anëtarët e BIA-s kishin një *modus operandi* të tyre. Në ahuret ku mbaheshin, viktimat goditeshin me shkelma, grushte dhe shuplaka çdo ditë. Gjithashtu, anëtarët e BIA-s i nxirrnin të ndaluarit nga ahuret një nga një dhe i dërgonin – më të shumtën e kohës – në një dhomë që ndodhej mbi njërin prej ahureve, ku i merrnin në pyetje ashpërsisht dhe i rrihnin brutalisht. Të ndaluarit u rrahën, shpesh nga disa anëtarë të BIA-s njëherësh, u goditën me shkop bejsbolli, shufra hekuri dhe shkop gome, u dogjën, u vunë nën rrymë, u shpuan me thikë, u shkelmuan, u goditën me grushte dhe shuplaka.

37. Ata u morën në pyetje ashpërsisht dhe u akuzuan si spiunë, bashkëpunëtorë të serbëve, tradhtarë, hajdutë, ose gënjeshtarë. Ata u urdhëruan të shprehin mbështetje për UÇK-në dhe u detyruan të bërtisnin: “Vdekje tradhtarëve, vdekje hajnave, dhe lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, siç kujton një dëshmitar.

38. Keqtrajtimi u shkaktoi të ndaluarve lëndime të rënda: ata u mavijosën, mbuluan me gjak, nuk ishin në gjendje të ngriheshin në këmbë apo të flisnin, dhe nganjëherë humbën ndjenjat. Një i ndaluar – viktimë e vrasjes së paligjshme të pretenduar – u keqtrajtua aq rëndë sa ishte pothuajse i vdekur. Një dëshmitar tha – në mënyrë domethënëse që tregonte vuajtjet e skajshme që kishte kaluar – se më mirë ta kishin vrarë.

39. Vetë z. Mustafa mori në pyetje dhe keqtrajtoi dy nga të ndaluarit, në raste të ndryshme. Njërin prej tyre bëri sikur do ta ekzekutonte. Gjithashtu atë e goditi në mënyrë të përsëritur në çdo pjesë të trupit. Z. Mustafa gjithashtu urdhëroi vartësit e tij ta rrihnin njërin prej të ndaluarve derisa humbi ndjenjat, si dhe ishte i pranishëm herë të tjera kur të ndaluarit u keqtrajtuat nga vartësit e tij të BIA-s.

40. Të ndaluarit u keqtrajtuat edhe psikologjikisht nga anëtarët e BIA-s. Nga ahuret ku mbaheshin, ata shihnin e dëgjonin të ndaluarit e tjerë kur rriheshin si dhe shihnin lëndimet që kishin pësuar. Për pasojë, ata jetonin me frikën e vazhdueshme se do t'u vinte radha. Një dëshmitar tha: "Ke ndi zona, për shembull, ke ndi zona të njerëzve... t'u bo si qen, si macja... prej torturës, prej dhimbjeve". Një tjetër shpjegoi se këto dëgjoheshin pothuajse çdo natë dhe nuk mund të flinin. Dëshmia e një dëshmitari flet vetë lidhur me ngarkesën e jashtëzakonshme psikologjike: "Ke nejt ke pritun kush po vjen me të rreh ose me të marrë me të çu nalt", je ndje shumë keq edhe ke prit veç vdekjen, por, kur po të vjen... sot, nesër, kur po të mytin".

41. Keqtrajtimi fizik dhe psikologjik, bashkë me kushtet çnjerëzore dhe poshtëruese të ndalimit, u shkaktuan të ndaluarve lëndime të përhershme fizike dhe psikologjike.

42. Trupi Gjykses konstatoi se z. Mustafa dhe vartësit e tij të BIA-s qëllimisht u shkaktuan dhimbje e vuajtje të mëdha fizike e mendore të paktën gjashtë personave të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash me synim marrjen e informatave ose deklaratave pranuese, duke i ndëshkuar, frikësuar ose shtrënguar viktimat dhe/ose duke i diskriminuar për arsye politike.

43. Duke marrë parasysh në tërësi keqtrajtimin që vuajtën viktimat, Trupi Gjykses rrjedhimisht konstatoi se Prokurori i Specializuar ka vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm se krimi i luftës i torturës në Pikën 3 u krye kundër së paku gjashtë personave në kompleksin e ndalimit në Zllash, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999.

44. Trupi Gjykses gjykoi se akuza e trajtimit mizor mbulohej tërësisht nga akuza e torturës dhe rrjedhimisht vendosi të mos e shqyrtonte më tej. Kjo u bë për hir të drejtësisë për z. Mustafa.

## **Më tej do të kaloj në Pikën 4: Vrasje e paligjshme**

45. Trupi Gjykues vërtetoi se më 19 prill 1999 apo rreth kësaj date, në kontekstin e ofensivës serbe që po afrohej në zonën përreth Zllashit, anëtarët e BIA-s nën autoritetin e z. Mustafa, si komandant i tyre, liruan disa nga të ndaluarit e kompleksit të ndalimit në Zllash. Ata gjithashtu i evakuuan objektet e këtij kompleksi. Megjithëkëtë, dhe pavarësisht nga rrethanat e jashtëzakonshme të krijuara nga ofensiva, Trupi Gjykues konstatoi se dy të ndaluar nuk u liruan nga vartësit e z. Mustafa në BIA. Këta të ndaluar, jo rastësisht sipas vlerësimit të provave nga Trupi Gjykues, ishin dy më të keqtrajtuarit. Njëri u pa për herë të fundit nga të ndaluarit e tjerë pothuajse i vdekur, i cili nuk mund të lëvizte. Më pas ai u gjet i vdekur. Trupi Gjykues konstatoi se identiteti i kufomës së viktimës u vërtetua - në bazë të tërësisë së dëshmive, dokumenteve dhe fotografive - se ishte njëri prej dy të ndaluarve që nuk u liruan nga kompleksi i ndalimit në Zllash.

46. Duke pasur parasysh se z. Mustafa ishte komandanti i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s, që kishte kontroll të plotë mbi kompleksin e ndalimit në Zllash, Trupi Gjykues konstaton se përfundimi i vetëm i arsyeshëm është se z. Mustafa vendosi të lironte disa nga të ndaluarit dhe ta mbante viktimën e vrasjes së paligjshme në ndalim, duke mos i dhënë ndihmë mjekësore dhe duke mos e evakuuar. Këto vendime, të marra nga z. Mustafa si komandant i BIA-s dhe në kontekstin e ofensivës serbe që po afrohej - faktikisht ishin barabar me vendim për vrasjen e viktimës së vrasjes së paligjshme, duke qenë se në atë fazë atij iu mohua çdo mundësi për të mbijetuar.

47. Trupi Gjykues konstatoi se viktimja e vrasjes së paligjshme vdiq afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999. Shkaqet e vdekjes ishin: keqtrajtimi i rëndë i shkaktuar nga anëtarët e BIA-s të cilët e mbajtën të ndaluar për rreth tri javë; refuzimi i ndihmës mjekësore nga anëtarë të BIA-s; dhe disa plagë me armë zjarri që iu gjetën në trup. Provat vërtetuan pa asnjë dyshim se dy shkaqet e para të vdekjes, konkretisht keqtrajtimi i skajshëm i viktimës së vrasjes së paligjshme dhe refuzimi i ndihmës

mjekësore, ishin tërësisht rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të z. Mustafa dhe vartësve të tij të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash.

48. Sa i takon shkakut të tretë të vdekjes, gjegjësisht plagëve me armë zjarri, ndonëse përfundimi më me gjasë ishte se anëtarët e BIA-s qëlluan me plumba viktimën e vrasjes së paligjshme përpara se të largoheshin nga kompleksi i ndalimit në Zllash, ky nuk ishte i vetmi përfundim i arsyeshëm bazuar në tërësinë e provave. Ekziston në fakt dyshim i arsyeshëm nëse plagët me armë zjarri që u identifikuan në trupin e viktimës së vrasjes së paligjshme mund t'u atribuohen anëtarëve të BIA-s apo forcave serbe, për arsyet që shpjegohen me hollësi në aktgjykim. Megjithatë, Trupi Gjykses nxori përfundimin se ky dyshim i arsyeshëm nuk pati ndikim në atribuimin e vdekjes së viktimës zotit Mustafa. Kjo, sepse keqtrajtimi i skajshëm i viktimës së vrasjes së paligjshme, së bashku me refuzimin e ndihmës mjekësore, në kontekstin e vendimeve të z. Mustafa si komandant i BIA-s që viktima të mos lirohej e të mos evakuohej kur forcat serbe iu afruan zonës, përbënin shkaqe thelbësore të vdekjes së viktimës, pavarësisht nëse viktima u godit nga një apo më shumë plumba serbë.

49. Me fjalë të tjera, Trupi Gjykses gjykoi se të shtënat me armë zjarri drejtpërdrejt ndaj viktimës, apo vënia e tij në pozitën që të qëllohej nga forcat serbe që po përparonin — duke e braktisur pa mbrojtje në një gjendje në prag të vdekjes në kompleksin e ndalimit në Zllash — çonte saktësisht në të njëjtin përfundim. Ky përfundim është që vdekja e viktimës mund t'u atribuohet veprimeve dhe mosveprimeve të z. Mustafa, si komandant i BIA-s.

50. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se z. Mustafa kishte synimin ta vriste viktimën e vrasjes së paligjshme.

51. Trupi Gjykses, rrjedhimisht konstatoi se Prokurori i Specializuar ka vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm se krimi i luftës i vrasjes së paligjshme në Pikën 4 u krye kundër një personi në kompleksin e ndalimit në Zllash afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999.

## **Tani do të trajtoj konfliktin e armatosur – lidhjen me konfliktin – dijeninë**

52. Trupi Gjykses më tej konstatoi se krimet e paraqitura në Aktakuzë u kryen në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe. Z. Mustafa ishte në dijeni të rrethanave që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar. Ai ishte gjithashtu në dijeni të statusit të viktimave si persona që nuk merrnin pjesë aktive në veprime luftarake, duke qenë se u ishte hequr liria në kompleksin e ndalimit në Zllash nën kontrollin e tij.

## **Përgjegjësia penale individuale**

53. Tani do të trajtoj natyrën e pjesëmarrjes së z. Mustafa në kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzë.

54. Trupi Gjykses konstatoi se z. Mustafa keqtrajtoi drejtpërdrejt dhe personalisht dy të ndaluar. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses e gjykoi të përshtatshme që këtë sjellje ta trajtonte në kuadër të kryerjes së drejtpërdrejtë si formë e përgjegjësisë penale. Arsyeja është se z. Mustafa *synonte* të përfshihej në atë sjellje, ndër të tjera edhe me qëllimet përkatëse të torturës si krim lufte.

55. Sa u takon krimeve të tjera, z. Mustafa së bashku me vartësit e tij të BIA-s dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së, kishin qëllimin e përbashkët që të ndalonin dhe keqtrajtonin të ndaluarit e mbajtur nga BIA në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe të mbanin në ndalim, keqtrajtonin dhe përfundimisht të vrisnin viktimën e vrasjes së paligjshme.

56. Trupi Gjykses konstatoi se z. Mustafa dha një numër kontributesh të qenësishme në realizimin e qëllimit të përbashkët, si komandant i BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash: (i) ai personalisht torturoi dy të ndaluar, duke u dhënë kështu shembull ose nxitje vartësve të tij në BIA që të kryenin veprime të ngjashme kundër të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash; (ii) urdhëroi vartësit e tij të BIA-s që t'i torturonin

disa të ndaluar dhe t'i kthenin në ahuret ku mbaheshin; (iii) ai u refuzoi ndihmë mjekësore të ndaluarve, pavarësisht nga keqtrajtimi dhe lëndimet e tyre; (iv) nuk i liroi të ndaluarit, duke lejuar kështu që vartësit e tij të BIA-s t'i keqtrajtonin deri sa ndodhi një ndryshim i jashtëzakonshëm në rrethana, konkretisht ofensiva serbe; dhe (v) asnjëherë nuk e liroi apo evakuo viktimën e vrasjes së paligjshme, i cili vazhdoi të ishte në ndalim kur z. Mustafa dhe vartësit e tij të BIA-s u larguan nga kompleksi i ndalimit në Zllash për shkak të afrimit të ofensivës serbe.

**57. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se z. Mustafa ka përgjegjësi penale si kryes i drejtpërdrejtë i krimit të luftës të torturës në Pikën 3, vetëm për incidentet kundër dy të ndaluarve në të cilat z. Mustafa mori pjesë personalisht.**

**58. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se Z. Mustafa ka përgjegjësi penale, përmes kontributit të tij të qenësishëm në një ndërmarrje kriminale të përbashkët, për krimin e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1) dhe torturës (Pika 3) kundër më së paku gjashtë të ndaluarve, si edhe për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme (Pika 4) kundër një të ndaluarit.**

## **Dënimi**

59. Para shqiptimit të vendimit dhe të dënimit, do të bëj një përmbledhje të shkurtër të qëllimeve të dënimit dhe të faktorëve të shqyrtuar nga Trupi Gjykses në përcaktimin e dënimit të përshtatshëm për veprat penale për të cilat z. Mustafa është penalisht përgjegjës.

60. Përpara se ta bëjë këtë, Trupi Gjykses dëshiron të informojë se **më pas** do të lëshojë një urdhër për zhdëmtim, në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit dhe ruan juridiksionin e nevojshëm në lidhje me këtë.

61. Trupi Gjykses rikujton se ndëshkimi dhe parandalimi janë ndër qëllimet kryesore të dënimit të individëve të shpallur fajtor për vepra penale.

62. Gjithashtu, Trupi Gjykses dëshiron të theksojë rëndësinë e nxjerrjes para drejtësisë të kryesve të krimeve të rënda që janë shqetësim për bashkësinë

ndërkombëtare në tërësi, për t'i dhënë fund mosndëshkimit – edhe dekada pas ngjarjeve në fjalë dhe pavarësisht nga ekzistenca prej kohësh e atmosferës mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë.

63. Një qëllim tjetër i rëndësishëm i dënimit është njohja e dëmit dhe vuajtjeve që u janë shkaktuar viktimave dhe shoqërisë.

64. Së fundi, Trupi Gjykses thekson se krimet në këtë çështje u kryen vetëm kundër shqiptarëve kosovarë. Trupi Gjykses është gjithashtu i mendimit se zbulimi i së vërtetës si rezultat i këtij aktgjykimi mund të kontribuojë më tej në pajtimin ndërmjet grupeve të prekura në Kosovë, për të kontribuar në rivendosjen dhe ruajtjen e paqes.

65. Trupi Gjykses shqyrtoi peshën e krimeve dhe të pasojave të tyre, kontributin personal të z. Mustafa në ato krime, rrethanat personale të personit të shpallur fajtor dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si faktorë të rëndësishëm për përcaktimin e dënimit të përshtatshëm.

66. **Sa i takon peshës së krimeve,** Trupi Gjykses gjykoi se ndalimi arbitrar është i rëndë, sepse i bën viktimat të cenueshme ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut; tortura përfaqëson cenim të dinjitetit, sigurisë, dhe mirëqenies mendore dhe fizike të njeriut; dhe vrasja e paligjshme është vetiu një nga krimet më të rënda.

67. Në këtë çështje, të paktën gjashtë të ndaluarve iu hoq liria në kompleksin e ndalimit në Zllash në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese, pa asnjë garanci bazë, dhe ata rregullisht u keqtrajtuuan psikologjikisht dhe fizikisht. Për më tepër, një i ndaluar vdiq si rezultat i keqtrajtimit të rëndë nga anëtarë të BIA-s të cilët e mbajtën në ndalim për pothuaj tri javë, i refuzimit të ndihmës mjekësore nga anëtarë të BIA-s, dhe plagë nga armë zjarri të gjetura në trup, në lidhje me të cilat Trupi Gjykses konstatoi se ekziston dyshim i arsyeshëm nëse mund t'u atribuohen anëtarëve të BIA-s ose të forcave serbe. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses nuk e merr parasysht shkakun e fundit të vdekjes në përcaktimin e dënimit.

68. **Sa u takon pasojave të krimeve,** Trupi Gjykses mbajti parasysh se viktimat në këtë çështje gjyqësore vuajtën nga lëndime afatgjata, si fizike ashtu edhe mendore. Gjithashtu, ata përjetuan pasoja negative në marrëdhëniet personale dhe jetën familjare. Më tej, disa e patën dhe e kanë të vështirë të fitojnë jetesën. Trupi Gjykses gjithashtu mori parasysh ndikimin e vrasjes së paligjshme jo vetëm tek viktima e drejtpërdrejtë dhe ata që ishin dëshmitarë të keqtrajtimit të tij, por edhe tek anëtarët e familjes së viktimës që ai ka lënë pas.

69. Trupi Gjykses gjithashtu mori parasysh dy rrethana rënduese, konkretisht se, siç u përshkrua më lart, tortura u krye me egërsi të veçantë dhe viktimat ishin veçanërisht të cenueshme apo të pambrojtura, duke pasur parasysh statusin, izolimin, dhe në disa raste, moshën e re të tyre (njëri prej tyre, për shembull, ishte 18 vjeç).

70. Për këto arsye, Trupi Gjykses vlerësoi se pesha e krimeve të shqyrtuara ishte e rëndë.

71. **Sa i përket kontributit personal të z. Mustafa në këto krime,** Trupi Gjykses mbajti parasysh pozitën eprore dhe rolin qendror të z. Mustafa në një sistem ndalimesh të paligjshme dhe torturash në kompleksin e ndalimit në Zllash, së bashku me miratimin dhe mbështetjen në vijimësi prej tij të të njëjtave veprime në periudhën midis ose rreth 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999.

72. Trupi Gjykses gjithashtu mbajti parasysh se z. Mustafa personalisht dhe qëllimisht i torturoi dy prej të ndaluarve.

73. Më tej, Trupi Gjykses gjykoi se z. Mustafa kishte synimin e trajtimit vdekjeprurës që iu bë viktimës së vrasjes së paligjshme dhe që ai keqtrajtoi të vazhdonte për rreth 19 ditë ndërkohë që i refuzoi ndihmë mjekësore, garanci bazë, apo lirim, që ishin në kompetencë të tij si komandant i BIA-s. Përfundimisht, z Mustafa, në cilësinë e tij si komandant i BIA-s, vendosi të mos e lironte viktimën e vrasjes së paligjshme — çka faktikisht ishte barabar me vendim për vrasjen e tij.



74. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i vlerësoi shkallën e kontributit personal të z. Mustafa në krimet e shqyrtuara, si dhe synimin e tij, si shumë të lartë.

75. Së fundi, Trupi Gjykses nuk u dha peshë të konsiderueshme **rrethanave personale** të z. Mustafa, duke pasur parasysh llojin dhe peshën e krimeve të vërtetuara dhe kontributin e tij në to.

### **Tani do të shqiptoj vendimin**

Z. Salih Mustafa, ju lutem ngrihuni në këmbë.

[i akuzuari ngrihet në këmbë]

Në emër të popullit të Kosovës, për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim dhe të përmbledhura më lart dhe, duke marrë parasysh të gjitha provat dhe argumentet e palëve dhe mbrojtëses së viktimave, Trupi Gjykses, në bazë të neneve 43 dhe 44 të Ligjit dhe rregullave 158, 159, 163 dhe 165 të Rregullores, ju shpall ju, z. Mustafa, **FAJTOR** për:

- a) Pikën 3, torturë si krim lufte, sipas neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit (kryerje e drejtpërdrejtë);
- b) Pikën 1, ndalim arbitrar si krim lufte, sipas neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit (si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët në formën bazë të saj);
- c) Për Pikën 3, torturë si krim lufte, sipas neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit (si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët në formën bazë të saj);
- d) Pikën 4, vrasje e paligjshme si krim lufte, në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit (si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët në formën bazë të saj).

Trupi Gjykses ju shpall **TË PAFAJSHËM** për krimin e luftës të trajtimit mizor në Pikën 2.

### **Tani do të shqiptoj dënimin**

Z. Mustafa, duke qenë se jeni shpallur fajtor për më shumë se një vepër penale, Trupi Gjykses ka përcaktuar nga një dënim më vete për secilën vepër penale, për të cilën

është dhënë vendim fajësie në bazë të rregullës 163(4) të Rregullores. Së pari do të jap këto dënime më vete, e më pas do të shqiptoj dënimin e njësuar për sjelljen tuaj kriminale në tërësi.

Trupi Gjykes ka përcaktuar:

- (i) dënim me 10 (dhjetë) vjet burgim për krimin e luftës së ndalimit arbitrar (Pika 1);
- (ii) dënim me 22 (njëzet e dy) vjet burgim për krimin e luftës të torturës (Pika 3); dhe
- (iii) dënim me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme (Pika 4).

Trupi Gjykes ju dënon me dënim të njësuar me **26 (njëzet e gjashtë) vjet** burgim, në të cilin llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

Z. Mustafa, mund të uleni.

Zyra Administrative tani do të shpërndajë Aktgjykimin në formë elektronike. Një kopje e legalizuar e versionit në gjuhën angleze do t'i jepet z. Mustafa sa më shpejt sot. Versioni në gjuhën shqipe do t'i jepet z. Mustafa pasi të jetë gati.

Trupi Gjykes do të nxjerrë një version të redaktuar publik të Aktgjykimit më pas.

Trupi Gjykes rikujton se ruan juridiksion në këtë çështje në lidhje me lëshimin më pas të Urdhrit për Zhdëmtim ku do të specifikohet kompensimi i përshtatshëm për viktimat ose në lidhje me ta, në pajtim me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

Para mbylljes së seancës, Trupi Gjykes do të shqiptojë edhe një urdhër gojor.

Trupi Gjykes gjykon se kufizimet në fuqi të kontakteve dhe komunikimeve të z. Mustafa nuk janë më as të nevojshme, as proporcionale në këtë fazë të procesit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes vendos t'i shfuqizojë *proprio motu* këto masa, vendim që hyn në fuqi të mërkurën, 21 dhjetor 2022, në mesditë.

Trupi Gjykues do të nxjerrë arsyet e veta me shkrim javën e ardhshme në bazë të rregullës 75(2) të Rregullores.

Seanca mbyllet.